



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr.

Pejë, 27.08.2026

Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2026 në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 118 të Statutit të Universitetit, nenin 7 të Rregullorës për Studimet e Doktoratës me nr. 3021 të datës 18.11.2024 dhe në bazë të vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me nr. ref. 01 - 2299 të datës 01.06.2026, shpall:

KONKURS

për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027

1. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë në studimet e doktoratës për vitin akademik 2026/2027 do të pranojë deri në 9 studentë, në programin Biznes dhe Ekonomi në kuadër të Fakulteti të Biznesit.

2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti "Haxhi Zeka" do të regjistrojë deri në 12%, përkatësisht 1 studentë të rregullt nga komuniteti jo shumicë.

Fakulteti i Biznesit

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%
BE	Biznes dhe Ekonomi, PhD	9	8	1

I. KUSHTET E KONKURSIT

1. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet në Fakultetet, respektivisht programet përkatëse.

2. Në studimet e doktoratës nuk mund të regjistrohen të diplomuarit me master profesional.

3. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë kandidatët me notë mesatare jo më të ultë se 8.00 në secilin nivel të studimeve paraprake bachelor dhe master veç e veç, të diplomuar në njërin nga nivelet vijuese:

- 3.1. Të diplomuarit para hyrjes në fuqi të studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës, të cilët duhet të jenë magjistër të shkencës përkatëse;
 - 3.2. Të diplomuarit pas hyrjes në fuqi të studimeve në bazë të Deklaratës së Bolonjës - niveli i studimeve Master shkencor;
 - 3.3. Të diplomuarit që kanë së paku 300 ECTS kredi (European Credit Transfer System);
 - 3.4. Përrjashtimisht nga pika 3.1, 3.2 dhe 3.3, në rast se kandidatët vijnë nga jashtë sistemit të Bolonjës, për bazë do të merret nostrifikimi i ministrisë përkatëse.
4. Kriteret e vlerësimit të kandidatëve për regjistrim në studimet e doktoratës përfshijnë:
- 4.1. Kandidatët duhet t'i kenë të përfunduara studimet paraprake në fushën e njëjtë ose të afërt me studimet e doktoratës. Fushat e afërta përcaktohen nga Këshilli i doktoratës së njësisë përkatëse akademike, dhe vlejnë për tërë periudhën e akreditimit të programit përkatës, të cilat publikohen në konkurs në kuadër të seksionit të kushteve të veçanta për njësinë akademike përkatëse. Vlerësimi i fushës së kandidatit bëhet nga Këshilli i doktoratës së njësisë përkatëse akademike para se t'i nënshtrohen provimit pranues.
 - 4.2. Suksesi në shkollimin gjatë studimeve, nota mesatare 8.00 e më lart në të dy nivelet Bachelor dhe Master (magjistër) veç e veç. Përkatësisht nota mesatare e studimeve të integruara, vlerësohet maksimalisht me 30 pikë, të cilat llogariten duke shumëzuar notën mesatare aritmetike të studimeve Bachelor dhe Master me 3.
 - 4.3. Dëshmi për njohjen e gjuhës angleze. Kriteret e vlerësimit të njohjes së gjuhës angleze janë të njëjta për të gjitha njësitë akademike. Çdo kandidat duhet të dëshmojë zotërim të gjuhës angleze, së paku në nivelin B2. Kandidatët të cilët kanë dëshmi nga testet e njohura ndërkombëtarisht, TOEFL dhe IELTS, të cilat janë administruar nga institucione të akredituara sipas Komisionit Evropian të Referencës për Gjuhët (CEFR) duhet të dëshmojnë se kanë arritur këto rezultate: për TOEFL, rezultati 72 pikë jep 10 pikë, ndërsa për IELTS, minimumi 5.5 jep 10 pikë. Të shprehura me shifra janë si në vijim: për TOEFL, $72 - 79 = 10$ pikë, $80 - 87 = 15$ pikë, mbi 88 = 20 pikë. Ndërsa për IELTS, 5.5 = 10 pikë, 6.0 - 15 pikë, mbi 6.5 = 20 pikë. Njohuria e gjuhës angleze vlerësohet maksimalisht me 20 pikë. Kandidatët që nuk paraqesin dëshmi të TOEFL-it dhe IELTS-it, iu nënshtrohen provimit pranues për gjuhën angleze në nivelin B2, i cili organizohet nga universiteti, sipas orarit të shpallur në konkurs për pranim të studentëve të doktoratës.
 - 4.4. Aktivitetet shkencore/artistike të botuara vlerësohen deri në 20 pikë maksimale:
 - 4.4.1. Për çdo artikull të publikuar në pesë vitet e fundit dhe të indeksuar në platformën Web of Science (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe/ose SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4): autori i parë/korrespondent 5 pikë, të tjerët 2 pikë.
 - 4.4.2. Për çdo artikull të botuar në pesë vitet e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara në platformat e specifikuara në

- rregulloren në fuqi për procedurat përzgjedhëse lidhur me personelin akademik: autori i parë/korrespondent 3 pikë, të tjerët 1 pikë.
- 4.4.3. Për çdo artikull të publikuar në pesë vitet e fundit në revista akademike vendore të cilat i nënshtrohen recensionit profesional: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
- 4.4.4. Për libër universitar të botuar në pesë vitet e fundit nga lëmi e ngushtë: autori i parë 5 pikë, bashkautori 3 pikë. Monografia e botuar në fushën ku aplikon kandidati vlerësohet me 4 pikë.
- 4.4.5. Për çdo prezantim të punimit në pesë vitet e fundit në konferenca, kongrese, apo simpoziume ndërkombëtare shkencore të indeksuara dhe të botuara në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
- 4.4.6. Për çdo prezantim në pesë vitet e fundit në konferenca, kongrese, apo simpoziume shkencore vendore: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.

4.5. Provimi pranues organizohet dhe administrohet nga njësitë akademike, duke respektuar standardet më të larta akademike. Në rastet e prezencës së konfliktit të interesit, duhet të evitohet përfshirja e personelit përkatës në të gjitha fazat e provimit pranues. Nëse ka situata të tilla, senati i universitetit mund të kërkojë nga fakulteti të marrë masa shtesë për të evituar diskreditimin e provimit pranues. Komisioni pranues do të emërohet nga Këshilli i njësisë akademike përkatëse.

4.6. Kandidatët kanë të drejtë ti nënshtrohen provimit pranues dhe të ftohen në intervistë nëse komisioni përkatës i fakultetit paraprakisht konstaton se ata plotësojnë kushtet e konkursit dhe kanë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm të plotësuar.

4.7. Provimi pranues përfshin provimin lidhur me aspektin profesional/shkencor. Nga provimi pranues profesional/shkencor, kandidatët mund të fitojnë maksimalisht 30 pikë.

4.8. Projekt propozim i tezave të doktoratës nga lëmi përkatës ku aplikon, dhe intervista e kandidatit, vlerësohet me 40 pikë maksimale.

4.9. Kandidatët renditen në listë sipas pikëve të fituara, dhe përzgjedhja e kandidatëve të pranuar bëhet në bazë të pikëve të grumbulluara, duke marrë parasysh numrin e studentëve të përcaktuar për regjistrim nga senati i Universitetit.

II. KUSHTET E VEÇANTA TË KONKURSIT TË PËRCAKTUARA NGA FAKULTETI

FAKULTETI I BIZNESIT

I. Fushat e përafërta të studimit për programin e Doktoratës në Biznes dhe Ekonomi

Në përputhje me vendimin e Këshillit të Fakultetit të Biznesit, të datës 06.07.2026, bazuar në propozimin e Këshillit të Përkohshëm të Studimeve të Doktoratës, fushat e

përafërta të studimit të cilat konsiderohen të pranueshme për aplikim në programin e doktoratës në Biznes dhe Ekonomi janë të përcaktuara sipas kodeve të fushave të studimit në zonën Erasmus dhe janë të vlefshme për të gjithë periudhën e akreditimit të këtij programi. Fushat e përafërta janë si më poshtë:

- 01.2 Agricultural Economics
- 04.0 Business Studies, Management Science
- 04.2 Business Studies with Technology
- 04.3 Accountancy, Financial Management
- 04.4 Tourism, Catering, Hotel Management
- 04.5 Industrial Relations and Personnel Management
- 04.7 Marketing and Sales Management
- 04.9 Other Business Studies, Management Science
- 06.0 Engineering, Technology
- 11.0 Mathematics, Informatics
- 11.1 Mathematics
- 11.2 Statistics
- 11.3 Informatics, Computer Science
- 11.4 Artificial Intelligence
- 11.5 Actuarial Science
- 11.9 Others Mathematics, Informatics
- 14.0 Social Sciences
- 14.1 Political Science
- 14.2 Sociology
- 14.3 Economics
- 14.4 Psychology and Behavioural Sciences
- 14.5 Social Work
- 14.6 International Relations, European Studies, Area St.
- 14.7 Anthropology
- 14.8 Development Studies
- 14.9 Others Social Sciences

II. Provimi i gjuhës angleze (TOEFL/IELTS)

Kandidatët që nuk posedojnë një certifikatë valide të gjuhës angleze TOEFL ose IELTS (e njohur ndërkombëtarisht dhe e lëshuar brenda periudhës së vlefshmërisë së përcaktuar nga institucionet përkatëse) janë të detyruar t'i nënshtrohen provimit të gjuhës angleze, i cili organizohet sipas standardeve të TOEFL ose IELTS.

- Provimet e gjuhës angleze organizohen në hapësirat e Universitetit Amerikan në Kosovë – RIT Kosovo (A.U.K.), në Prishtinë, sipas orareve zyrtare të publikuara nga ky institucion.
- Paraqitja në provim, ndjekja e të gjitha procedurave të aplikimit, si dhe mbulimi i shpenzimeve të provimit janë përgjegjësi e vetë kandidatit.

- Kandidatët janë të obliguar që rezultatet e provimit t'i dorëzojnë personalisht në Zyrën e Studimeve të Doktoratës pranë Fakultetit të Biznesit, brenda afatit të përcaktuar në konkurs.

III. Provimi pranues profesional/shkencor

Provimi pranues profesional/shkencor organizohet me qëllim të vlerësimit të njohurive themelore të kandidatëve në fushat përkatëse të programit të doktoratës Biznes dhe Ekonomi. Provimi përfshin:

- Metodologjinë e hulumtimit shkencor, me theks në parimet e kërkimit akademik, hartimin e dizajnit kërkimor dhe etikën shkencore;
- Shkencat e Biznesit dhe të Ekonomisë, që mbulojnë në mënyrë të përgjithshme fushat themelore të kësaj disipline, në përputhje me natyrën ndërdisiplinare të programit.

Kandidatët pritet të demonstrojnë njohuri të avancuara teorike dhe aftësi analitike që tregojnë përgatitje për angazhim në kërkime të pavarura shkencore në nivel të doktoratës.

IV. Projekt-propozimi (koncepti ideor i hulumtimit)

Secili kandidat duhet të dorëzojë një projekt-propozim (koncept ideor) si pjesë e aplikimit për programin e doktoratës. Projekt-propozimi duhet të plotësojë këto kriterë formale dhe përmbajtësore:

- Të jetë me gjatësi maksimale 3 - 4 faqe A4, me font Times New Roman, madhësia 11, pa hapësira në mes rreshtave;
- Të përmbajë në mënyrë të strukturuar:
 1. Hyrjen
 2. Përshkrimin e problemit hulumtues, të mbështetur në literaturë relevante të publikuar në revista shkencore prestigjioze (preferohen revista të indeksuara në Scopus ose Web of Science);
 3. Pyetjet hulumtuese;
 4. Metodologjinë e paraparë për realizimin e hulumtimit;
 5. Planin e punës/hulumtimit;
 6. Referencat bibliografike përkatëse.

Projekt-propozimi vlerësohet në kuadër të procesit të intervistimit dhe shërben për të vlerësuar aftësitë kërkimore, qartësinë shkencore dhe përputhshmërinë tematike me fushat e programit të doktoratës.

V. Nënshkrimi i kontratës trepalëshe pas pranimit në studimet e doktoratës

Në përputhje me nenin 7, paragrafi 9 të Rregullores për Studimet e Doktoratës në Universitetin "Haxhi Zeka", pas pranimit në programin e doktoratës, çdo kandidat i pranuar është i obliguar të nënshkruajë një kontratë trepalëshe me:

- Universitetin "Haxhi Zeka",
- Studentin e doktoratës, dhe
- Mentor(in) (dhe nëse ka, bashkëmentorët).

Kontrata nënshkruhet pas përzgjedhjes zyrtare të mentorit dhe aprovimit të temës së doktoratës nga organet përkatëse akademike. Kjo kontratë ka për qëllim të rregullojë çështjet e mundshme kontestuese gjatë studimeve dhe përmban, ndër të tjera, edhe kushtet specifike për angazhimin e doktorantit.

Në veçanti, kontrata do të përfshijë obligimin që doktoranti të:

- marrë pjesë në mënyrë aktive në projektet shkencore–aplikative, dhe
- kontribuojë në aktivitetet akademike dhe kërkimore të Universitetit "Haxhi Zeka" dhe të Institutit për Shkencë dhe Arte, në përputhje me planin e studimeve dhe zhvillimit të karrierës akademike.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PER APLIKIM

Parakusht për vlerësimin e kandidatëve është dorëzimi i dokumentacionit origjinal si në vijim:

1. Çertifikatën ose ekstraktin e lindjes;
2. Diplomën dhe çertifikatën e notave (origjinale ose te noterizuara) nga studimet Bachelor, Master ose magjistratura shkencore.
3. Kandidatët që kanë kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i nënshtrohen njohjes së diplomave, me qëllim vazhdimin e studimeve, duke ndjekur procedurën sipas Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
4. Biografinë (CV);
5. Letrën motivuese (në të cilin arsyetohet interesi për kërkime shkencore në lëmin përkatës);
6. Konceptin ideor të hulumtimit (Projekt – propozimi);
7. Rekomandime të dy profesorëve nga lëmi përkatëse;
8. Dëshmitë (origjinale ose te noterizuara) për njohjen e gjuhës angleze (nëse posedojnë çertifikatë ndërkombëtare TOEFL më së paku 72 pikë ose IELTS më së paku 5.65 pikë);
9. Dëshmitë lidhur me publikimet/prezantimet nga veprimtaria kërkimore-shkencore (nëse posedojnë);

Paraqitja e dokumenteve të kompletuara bëhet në formë fizike në Zyrën për Studimet e Doktoratës, në kuadër të Fakultetit të Biznesit, si dhe në mënyrë elektronike përmes platformës zyrtare: <https://sims.unhz.eu/>

IV. AFATET E KONKURSIONIT

- a) Konkursi hapet nga data 27.08.2026 deri më 27.10.2026.
- b) Provimi i gjuhës angleze TOEFL/IELTS mbahet në Universitetin Amerikan në Kosovë – RIT Kosovo (A.U.K.), në Prishtinë, sipas orareve zyrtare të këtij institucioni. Kandidatët janë përgjegjës për paraqitjen dhe përmbushjen e të gjitha procedurave të nevojshme për pjesëmarrje në provim.
- c) Provimi pranues profesional/shkencor mbahet me datë 05.11.2026, në orën 10:00 h në Fakultetin e Biznesit. Informatat për sallën e mbajtjes së provimit pranues, do të publikohen në uebfaqe.
- d) Intervista me kandidatët do të mbahet më datë 10.11.2026 në Fakultetin e Biznesit. Të gjithë kandidatët do të njoftohen me kohë për orën dhe sallën e mbajtjes së intervistës përmes ueb-faqes zyrtare të universitetit.
- e) Rezultati preliminar: do të shpallet me datë 12.11.2026, deri në orën 16:00.
- f) Ankesat e kandidatëve do të pranohen me datën 13.11.2026 dhe 16.11.2026, deri në orën 16:00. Ankesat e kandidatëve shqyrtohen nga Komisioni për ankesa i Fakultetit të Biznesit.
- g) Rezultati përfundimtar: Njësitë përkatëse akademike, pas shqyrtimit të raportit të komisionit të ankesave hartojnë listat e kandidatëve të propozuar në nivel të njësie akademike dhe deri më 18.11.2026 i dërgojnë për shqyrtim në Këshillin qendror të studimeve të doktoratës. Senati i Universitetit, bazuar në propozimin e njësisë akademike dhe Këshillit qendror të studimeve të doktoratës, merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Emrat e kandidatëve të pranuar, me të gjitha të dhënat e kriterëve të përzgjedhjes, shpallen publikisht në ueb faqen e Universitetit.
- h) Data e regjistrimit të kandidatëve të pranuar do të publikohet pas vendimit përfundimtar të Senatit.